



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr: 257

**V E N D I M**

**P Ë R**

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT TË AUTORITETIT TË MEDIAS AUDIOVIZIVE TË**  
**PASOYRIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA OSHMA-TË**  
**PËR PERIUDHËN 04.04.2021 – 11.04.2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84, 85 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”

**V Ë R E J:**

Baza ligjore: nenet 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr.2, datë 30.01.2021 i Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”. Neni 85, pikat 1 dhe 6, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton se monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga enti rregullator që rregullon dhe mbikëqyr fushën e shërbimeve të transmetimeve audio/audiovizive në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet si dhe radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen, me kërkesë të KQZ-së, menjëherë në dispozicion të saj.



Nenet 6, shkronja “a”, dhe 8, të vendimit nr. 2 , datë 30.01.2021, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audi vizive” parashikojnë se OSHMA-t private me shtrirje rajonale që mbulojnë më pak se 48% të popullsisë bëhen me përzgjedhje në bazë të mbulimit gjeografik, audiencës, orareve të transmetimit, formatit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-t, lloji i medias, audienca e synuar nga kjo lloj media në publik/aktorët politik si dhe OSHMA-t vendore që nuk mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s, përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese”.

I.

### **Depozitimi i regjistrimeve në AMA**

Subjektet audiovizive, të cilët nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi nuk kanë depozituar të gjithë përmbajtjen të transmetuar nga subjektet OSHMA për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021 janë si më poshtë:

- TV Sot
- TV Channel 1
- TV Kopliku
- TV Klaudiana
- TV Skampa
- TV Saranda
- TV Glob
- TV Jug
- TV Gold
- TV Puka
- TV 4
- TV Adria Med

AMA informon se OSHMA-të:

- TV Antena Nord
- TV Channel 7
- TV Kukësi,

kanë depozituar regjistrime jo për të gjithë ditët e kësaj periudhe.

Nga shqyrtimi i përmbajtjeve të depozituara nga OSHMA “TV Kukësi” rezulton se janë depozituar përmbajtje të pjesshme ditore, ndërkohë që AMA ka kërkuara në mënyrë të përsëritur depozitim të gjithë përmbajtjeve të transmetuara nga subjektet OSHMA.

## **Propozim:**

### **1. AMA i propozon KQZ-së që për këto OSHMA të procedohet me marrje mase administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.**

Subjektet audiovizive të mëposhtme, janë evidentuar edhe në raportin e parë të dorëzuar nga AMA, si subjekte të cilat nuk kanë depozituar regjistrimet pranë AMA-s në zbatim të dispozitës ligjore të sipërcituar:

- TV Channel 1
- TV Kopliku
- TV Klaudiana
- TV Skampa
- TV Glob
- TV Jug
- TV Gold
- TV Puka
- TV 4

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos të procedojë me sanksion administrativ, gjobë për këto OSHMA, ndërsa për OSHMA-të e tjera Komisioneri vendos t'u tërheq vëmendjen të përmbushin menjëherë detyrimin ligjor.

## **II.**

### **Monitorimi i edicioneve informative**

Neni 81, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive private.

| <b>Nr.</b> | <b>OSHMA</b> | <b>PD</b> | <b>PS</b> | <b>LSI</b> | <b>PSD</b> |
|------------|--------------|-----------|-----------|------------|------------|
|------------|--------------|-----------|-----------|------------|------------|



|    |                  |         |         |         |         |
|----|------------------|---------|---------|---------|---------|
| 1  | RTSH 1           | 65 min  | -       | 87 min  | 91 min  |
| 2  | RTSH 2           | 13 min  | -       | 22 min  | 26 min  |
| 3  | TV Klan          | 148 min | -       | 147 min | 147 min |
| 4  | TV Top Channel   | 34 min  | -       | 53 min  | 54 min  |
| 5  | TV Vizion Plus   | 53 min  | -       | 74 min  | 91 min  |
| 6  | RTSH 24          | 76 min  | -       | 61 min  | 64 min  |
| 7  | Klan Plus        | 47 min  | -       | 41 min  | 50 min  |
| 8  | Klan News        | 352 min | -       | 277 min | 305 min |
| 9  | Top News         | 38 min  | -       | 79 min  | 81 min  |
| 10 | Kanal 7          | 25 min  | -       | 30 min  | 40 min  |
| 11 | News 24          | -       | 16 min  | 52 min  | 102 min |
| 12 | ABC News         | -       | 11 min  | 40 min  | 56 min  |
| 13 | RTV Ora          | 4 min   | -       | 35 min  | 48 min  |
| 14 | Report TV        | 229 min | -       | 150 min | 200 min |
| 15 | TV Scan          | 64 min  | -       | 58 min  | 87 min  |
| 16 | TV Ora News      | 19 min  | -       | 35 min  | 64 min  |
| 17 | TV Shijak        | -       | 106 min | 33 min  | 183 min |
| 18 | Euronews Balkans | -       | 13 min  | 92 min  | 123 min |
| 19 | Fax News         | 45 min  | -       | 37 min  | 53 min  |
| 20 | Syri TV          | -       | 55 min  | 89 min  | 127 min |
| 21 | RTSH Gjirokastra | 52 min  | -       | 43 min  | 109 min |
| 22 | TV Mati          | -       | 31 min  | 15 min  | 15 min  |
| 23 | Star Plus        | -       | 8 min   | 20 min  | 20 min  |
| 24 | TV 6+1           | 430 min | -       | 320 min | 299 min |
| 25 | TV Best          | 5 min   | -       | 26 min  | 47 min  |
| 26 | One Tv Vlora     | 172 min | -       | 111 min | 141 min |
| 27 | Belsh Tv         | -       | -       | 25 min  | 25 min  |

**2. Referuar të dhënave të tabelës nr.1.1, për edicionet informative, AMA i propozon KQZ-së që OSHMA-të e mëposhtme të bëjnë kompesimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim:**

### III.

AMA ka identifikuar dhe ka raportuar në informacionet ditore për KQZ-në se subjekti TV Bulqiza, ka përfshirë në përmbajtjet e saj audiovizive dhe transmetimin e edicioneve informative të një OSHMA-je tjetër.

#### **Propozim:**

#### **3. AMA i propozon KQZ-së që t'i drejtohet OSHMA-së për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi vlerësoi propozimin e AMA-s për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër nga TV Bulqiza, shprehet se KQZ nuk ka kompetencë në lidhje me këtë vendimmarrje në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

### IV.

#### **Monitorimi i Emisioneve**

IV/1

#### **Transmetimi i reklamave politike**

Në zbatim të nenit 84, pikat 4 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar OSHMA-të e mëposhtme nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor në lidhje me identifikimin e qartë të subjektit porosites të reklamave politike për periudhën 04.04.2021-11.04.2021:

- TV Klan (data 06 prill 2021)
- TV Top Channel (data 06 prill 2021)
- TV Vizion Plus (data 10 prill 2021)
- TV Fax News (data 06 prill 2021)
- Klan Plus (data 06 prill 2021)
- Klan News (data 06 prill 2021)
- Tv 6+1 (data 07,08,09,10,11 prill 2021)

#### **Propozim:**

#### **4. AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për mospërsëritjen e një shkelje të tillë.**



IV/2

Në zbatim në nenit 84, pikat 5 dhe 7, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar OSHMA-të, të cilat nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor në lidhje me oraret e transmetimit të reklamave politike për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021, më poshtë paraqiten OSHMA-të, të cilat nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor:

- TV Top Channel (data 04 prill 2021)
- TV News 24 (data 11 prill 2021)
- TV Shijak (datat 04-11 prill 2021)
- TV Kanal 7 (data 09 prill 2021)
- One Tv Vlora (datat 04-08 prill 2021 dhe 10-11 prill 2021)
- TV 6+1 (datat 04-11 prill 2021)
- TV Apollon ( datat 05-08 prill 2021)
- TV Best (datat 10-11 prill 2021)

**Propozim:**

**5. AMA i propozon KQZ-së t’i kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor.**

V.

AMA, për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021, ka konstatuar raste të transmetimit nga disa OSHMA të reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve. Konkretisht:

- TV Klan News (datat 04-11 prill 2021)
- TV 6+1 (data 05 prill 2021)
- TV Apollon (data 05 prill 2021)

**Propozim:**

**6. AMA i propozon KQZ-së t’i kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve. (të cilat nuk mund të sponsorizohen)**

VI

Duke iu referuar të dhënave të tabelës përmbledhëse për reklamat politike, rezulton se disa OSHMA kanë kaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues (që është përcaktuar deri në 90 min). Konkretisht kanë kaluar kohën e reklamave politike, OSHMA-të e mëposhtme:



| Nr | OSHMA        | PD      | PS      | Lëvizja për ndryshim |
|----|--------------|---------|---------|----------------------|
| 1  | TV Klan      | 132 min | 124 min | -                    |
| 2  | Top Channel  | -       | 99 min  | -                    |
| 3  | Klan Plus    | 105 min | 128 min | -                    |
| 4  | Klan News    | 133 min | 135 min | -                    |
| 5  | News 24      | -       | 108 min | -                    |
| 6  | ABC News     | -       | 100 min | -                    |
| 7  | Report TV    | -       | 101 min | -                    |
| 8  | TV Shijak    | 106 min | -       | -                    |
| 9  | Fax News     | 109 min | -       | -                    |
| 10 | One Tv Vlora | -       | 479 min | -                    |
| 11 | Tv 6+1       | 193 min | 206 min | 195 min              |

Sipas pikës 9 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, koha e transmetimit të reklamave për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore.

#### **Propozim:**

#### **7. AMA i propozon KQZ-së ti kërkojë OSHMA-ve të mësipërme të ndërpresin transmetimin e reklamës politike për subjektet zgjedhor respektive.**

Referuar nenit 84 pika 5 , të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, 11 Subjekte audiovizive kanë tejkalluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues (që është përcaktuar deri në 90 minuta), pasi ka transmetuar më shumë minuta reklamë politike për partitë politike PD dhe PS. Të njëjta subjekte audiovizive kanë tejkalluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues për partinë politike LN. Referuar nenit 84 pika 9 të të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, koha e transmetimit të reklamave për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore.

## VII

### **Raporti i përfaqësimit gjinor në fushatë**

Sa i takon vlerësimin gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën elektorale, për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021, përveç OSHMA-ve RTSH1, TV Klan, Top Channel, Euronews dhe One Tv Vlora, të cilët e kanë respektuar raportin gjinor të mbulimit mediatic të kandidatëve, pjesa tjetër e OSHMA-ve rezulton të mos këtë respektuar këtë raport.

OSHMA-të kombëtare dhe lokale/rajonale që mbulojnë më shumë se 48% të popullsisë rezulton se nuk kanë respektuar raportin e përfaqësimit gjinor në pasqyrimin e fushatës zgjedhore. AMA përsërit qëndrimin se respektimi i përfaqësimit gjinor në fushatën elektorale duhet të reflektojë realisht angazhimin dhe kontributin e femrave në shoqërinë shqiptare, në dinamikën e proceseve të demokratizimit dhe integritimit.

### **Propozim:**

- 8. AMA i propozon KQZ-së ti tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të jenë më të ndjeshme dhe të vëmendshme në respektimin e këtij kriteri.**

Respektimi i raportit të përfaqësimit gjinor në pasqyrimin e fushatës zgjedhore, është e dhënë cilësore e monitorimit dhe nuk përbën shkak ligjor për marrjen e masave administrative nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

## VIII

### **Publikimi i sondazheve zgjedhore**

Nisur nga monitorimi i respektimit të kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor (publikimi i sondazheve zgjedhore), për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021 në sondazhet që janë pasqyruar në përmbajtje të transmetuara nga OSHMA-të janë identifikuar 2 (dy) raste ku janë shkelur kërkesat e Kodit Zgjedhor. Konkretisht:

Në datën 07 prill 2021 dy OSHMA, Syri Tv dhe Report Tv, kanë transmetuar dhe rezultate zgjedhore. Gjatë publikimit të sondazhit në Syri Tv (nga ora 20:44 deri në 22:22) nuk është dhënë informacion mbi emrin e organizatorit, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e realizimit të sondazhit. Report Tv gjatë transmetimit të sondazhit (nga ora 21:01 deri më 23:59) nuk ka informuar ndjekësit për treguesit e probabilitetit të gabimit.





Neni 78, i Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, përcakton se: “*Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porositesin e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit*”.

**Propozim:**

- 9. AMA i propozon KQZ-së që t’i tërheqë vëmendjen 2 (dy) OSHMA-ve, që të respektojnë të gjitha kërkesat e nenit 78, të Kodit Zgjedhor.**

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84, 85 dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S:**

1. Marrjen e masës administrative, me vlerën 5000 (pesë mijë) lekë, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 4.4.2021 – 11.4.2021, për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA-të), si më poshtë vijon:
  - TV Channel 1
  - TV Kopliku
  - TV Antena Nord
  - TV Klaudiana
  - TV Skampa
  - TV Jug
  - TV Gold
  - TV Glob
  - TV Puka
  - Tv Adria Med
2. T’u tërheqë vëmendjen për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të depozituar pranë AMA-s regjistrime për periudhën 4.4.2021 – 11.4.2021, nga OSHMA-të, si më poshtë vijon:
  - TV Sot
  - TV 4



- TV Channel 7
- TV Kukësi
- Tv Saranda

3. Të bëjnë kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim, OSHMA-të e mëposhtme:

| Nr. | OSHMA            | PD      | PS      | LSI     | PSD     |
|-----|------------------|---------|---------|---------|---------|
| 1   | RTSH 1           | 65 min  | -       | 87 min  | 91 min  |
| 2   | RTSH 2           | 13 min  | -       | 22 min  | 26 min  |
| 3   | TV Klan          | 148 min | -       | 147 min | 147 min |
| 4   | TV Top Channel   | 34 min  | -       | 53 min  | 54 min  |
| 5   | TV Vizion Plus   | 53 min  | -       | 74 min  | 91 min  |
| 6   | RTSH 24          | 76 min  | -       | 61 min  | 64 min  |
| 7   | Klan Plus        | 47 min  | -       | 41 min  | 50 min  |
| 8   | Klan News        | 352 min | -       | 277 min | 305 min |
| 9   | Top News         | 38 min  | -       | 79 min  | 81 min  |
| 10  | Kanal 7          | 25 min  | -       | 30 min  | 40 min  |
| 11  | News 24          | -       | 16 min  | 52 min  | 102 min |
| 12  | ABC News         | -       | 11 min  | 40 min  | 56 min  |
| 13  | RTV Ora          | 4 min   | -       | 35 min  | 48 min  |
| 14  | Report TV        | 229 min | -       | 150 min | 200 min |
| 15  | TV Scan          | 64 min  | -       | 58 min  | 87 min  |
| 16  | TV Ora News      | 19 min  | -       | 35 min  | 64 min  |
| 17  | TV Shijak        | -       | 106 min | 33 min  | 183 min |
| 18  | Euronews Balkans | -       | 13 min  | 92 min  | 123 min |
| 19  | Fax News         | 45 min  | -       | 37 min  | 53 min  |
| 20  | Syri TV          | -       | 55 min  | 89 min  | 127 min |
| 21  | RTSH Gjirokastra | 52 min  | -       | 43 min  | 109 min |
| 22  | TV Mati          | -       | 31 min  | 15 min  | 15 min  |
| 23  | Star Plus        | -       | 8 min   | 20 min  | 20 min  |
| 24  | TV 6+1           | 430 min | -       | 320 min | 299 min |
| 25  | TV Best          | 5 min   | -       | 26 min  | 47 min  |

|    |              |         |   |         |         |
|----|--------------|---------|---|---------|---------|
| 26 | One Tv Vlora | 172 min | - | 111 min | 141 min |
| 27 | Belsh Tv     | -       | - | 25 min  | 25 min  |

4. Mospërsëritjen e transmetimit të reklamave politike të cilat nuk kanë identifikuar qartë subjektin porositës për OSHMA-të më poshtë vijon:

- TV Klan (data 06 prill 2021)
- TV Top Channel (data 06 prill 2021)
- TV Vizion Plus (data 10 prill 2021)
- TV Fax News (data 06 prill 2021)
- Klan Plus (data 06 prill 2021)
- Klan News (data 06 prill 2021)
- Tv 6+1 (data 07,08,09,10,11 prill 2021)

5. AMA t'u vendos në dispozicion OSHMA-ve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, të dhënat ditore ku janë konstatuar shkeljet, brenda 24 orëve nga miratimi i këtij vendimi.

6. Ndërprejten e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, për OSHMA-të si më poshtë vijon:

- TV Top Channel (data 04 prill 2021)
- TV News 24 (data 11 prill 2021)
- TV Shijak (datat 04-11 prill 2021)
- TV Kanal 7 (data 09 prill 2021)
- One Tv Vlora (datat 04-08 prill 2021 dhe 10-11 prill 2021)
- TV 6+1 (datat 04-11 prill 2021)
- TV Apollon ( datat 05-08 prill 2021)
- TV Best (datat 10-11 prill 2021)

7. AMA t'u vendos në dispozicion OSHMA-ve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, të dhënat ditore ku janë konstatuar shkeljet, brenda 24 orëve nga miratimi i këtij vendimi.

8. Të ndërpritet menjëherë transmetimi i reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve (të cilat nuk mund të sponsorizohen) për OSHMA-të si më poshtë vijon:

- TV Klan News (datat 04-11 prill 2021)



- TV 6+1 (data 05 prill 2021)
- TV Apollon (data 05 prill 2021)

9. OSHMA-të e mëposhtme të ndërpresin menjëherë transmetimin e reklamës politike për subjektet zgjedhor respektive:

1. TV Klan – PD dhe PS
2. Top Channel – PS
3. Klan Plus – PD dhe PS
4. Klan News – PD dhe PS
5. News 24 - PS
6. ABC News – PS
7. Report TV – PS
8. TV Shijak – PD
9. Fax News – PD
10. One TV Vlora – PS
11. TV 6+1 – PD, PS dhe LN

10. T'u tërheqë vëmendjen 2 (dy) OSHMA-ve, Syri Tv dhe Report Tv, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të dhënë informacion të detajuar, mbi publikimin e rezultateve të sondazheve në lidhje me emrin e organizatorit, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e realizimit të sondazhit.

11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

12. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
 Afati i ruajtjes: 5 vjet  
 Punoi  
 K.Puleri \_\_\_\_\_  
 V.Ballgjini \_\_\_\_\_  
 M.Koja \_\_\_\_\_  
 A.Lamçe \_\_\_\_\_  
 Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
 Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021



Data: 21 Prill 2021  
 Nr. 257

Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 04.04.2021 – 11.04.2021